

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6818
E hënë, 6 shkurt 2023
çmimi 0.40

Molliqaj: Për a kundër
Asociacionit të bëhemi
bashkë! | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HYSENI: 'GRUPI I TIRANËS' NË LV DËSHIRON KONFRONTIM KOSOVË - SHBA, OPOZITA TË MOS QËNDROJË INDIFERENTE

FAQE 4-5



Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, ka drejtuar kritika ndaj të ashtuquajturit "Grupi i Tiranës" në Lëvizjen Vetëvendosje. Ai ka thënë se ka kohë që ky grup, përpos politikave të LV-së, dikton

edhe politikat qeverisëse në Kosovë. "Krijimi dhe etablimi i politikave antiamerikane dhe antiperëndimore duket të jetë misioni i këtij 'Grupi' që ka për qëllim vënien e Kosovës në raporte

konfrontuese me ShBA-në dhe BE-në", ka theksuar Hyseni, duke i bërë thirrje opozitës të mos qëndrojë indiferente ndaj këtyre përpjekjeve dhe politikave të këtij grupi

LAJÇAKU VIZITON KOSOVËN



OSMANI: ËSHTË E RREZIKSHME TË KESH NJË FQINJE SI SERBIA



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



DHJETË PERSONA TË VDEKUR NGA
ORTEKËT NË AUSTRI DHE ZVICËR

F.2

UKRAINA PRETENDON SE 130 000
PJESËTARË TË USHTRISË RUSE
KANË VDEKUR NË LUFTË

F.2

INCIDENTI I DJEGIES SË KURANIT
BLOKON RRUGËN E SUEDISË
DREJT NATO-S

F.5

EKONOMI



15.5 MILIONË EURO MË SHUMË TË
HYRA PËR MUAJIN JANAR

F.7

TAHIRI: MBI 80 PËR QIND
E INVESTIMEVE NË TRUST KANË
HUMBUR PËR VITIN 2022

F.7

SPORT



PRISHTINA MPOSHTI PONTE
PRIZRENIN, YLLI IU RIKTHEHET
FITOREVE

F.10

Dhjetë persona të vdekur nga orteke të Austri dhe Zvicër

VJEN, 5 SHKURT - Dhjetë persona kanë vdekur si pasojë e disa ortekeve në malet austriake dhe ato zvicëranë përgjatë fundjavës. Turistë nga Zelanda e Re, Kina dhe Gjermania kanë qenë në mesin e të vdekurve në disa qendra skijimi. Autoritetet austriake kanë

aktivizuar nivelin e katërt të ortekeve, i dyti për nga rreziku - pas reshjeve intensive dhe erës në disa zona.

Niveli i katërt i alarmit në Austri nënkupton se "mund të krijohen orteke shumë të mëdhenj".

Skiatorët pa përvojë këshillohen që të qëndrojnë

në ambiente të hapura, ndërsa skiatorët me përvojë të qëndrojnë larg terreneve shumë të pjerrëta.

Pavarësisht prek paralajmërimeve, qendrat e skijimit në perëndim të Austrisë janë të mbushura për shkak të pushimeve dimërore në shkollat e Vjenës.



Ukraina pretendon se 130 000 pjesëtarë të ushtrisë ruse kanë vdekur në luftë

KIEV, 5 SHKURT - Ushtria ukrainase ka thënë se 131 290 pjesëtarë të ushtrisë ruse mund të kenë vdekur në Ukrainë që prej nisjes së luftës më 24 shkurt të vitit të kaluar. Në përditësimin e tij të rregullt, Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase ka pretenduar se 700 ushtarë rusë janë vrarë vetëm një ditë më parë.

Në këto përditësime në të cilat shifrat për viktimat janë më të larta sesa ato që i përpilon Perëndimi është thënë se Rusia ka humbur 3 220 tanke, 6 405 pajisje të armatosura dhe 2 226 sisteme të artilerisë prej nisjes së

luftës.

Për luftime të ashpra është raportuar edhe më 5 shkurt në Bahmut, qytet në lindje të Ukrainës, për kontrollin e të cilit ushtritë janë duke luftuar që disa muaj.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë më 3 shkurt se forcat ukrainase do të luftojnë për Bahmutin "aq sa të munden".

Ministria britanike e Mbrojtjes ka thënë javën e kaluar se Rusia ka bërë avancime të vogla në tentimet për ta rrethuar Bahmutin.

Presidenti rus Vladimir Putin e

quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Duke cituar zyrtarë amerikanë dhe ata të Perëndimit, e përditshmja amerikane "New York Times" ka raportuar më herët gjatë këtij muaji se numri i ushtarëve rusë të vrarë dhe të plagosur i afrohet shifrës 200 000.



Ish-kryeministri izraelit: Putini më ka premtuar se nuk do ta vrasë Zelenskyn

JERUSALEM, 5 SHKURT - Ish-kryeministri izraelit Naftali Bennett ka thënë se ka marrë premtim nga presidenti rus Vladimir Putin që nuk do ta vrasë homologun e tij ukrainas Volodymyr Zelensky.

Bennett ka shërbyer për periudhë të shkurtër si ndërmjetësues mes dy vendeve. Ai madje ka qenë një prej liderëve të paktë që e ka takuar Putinin pak javë pas nisjes së luftës në Ukrainë.

Ndonëse përpjekjet e Bennettit për ndërmjetësim mes dy vendeve duket se kanë pasur pak rezultat në ndalje të luftimeve, disa deklarata të bëra në një intervistë të dielën kanë vënë në pah diplomacinë



dhe masat urgjente që janë marrë për ta ulur shkallën e

konfliktit në ditët e para. Në një intervistë që ka zgjatur

për pesë orë, Bennett ka prekur shumë tema, dhe më pas ka thënë se i ka kërkuar Putinin nëse synon ta vrasë Zelenskyn. "E kam pyetur 'si është puna më të? A jeni duke planifikuar vrasjen e Zelenskyt?' Ai më ka thënë se 'nuk do ta vrasë Zelenskyn'. Më pas i kam thënë që të më japë fjalën se nuk do ta vrasë Zelenskyn. Ai ka thënë se 'nuk do ta vrasë Zelenskyn'". Bennett më pas ka thënë se e ka telefonuar Zelenskyn për ta informuar rreth premtimit të Putinin. "Më dëgjo, dola prej takimit, ai nuk do të të vrasë. Ai më pyeti 'a jeni i sigurt?' I kam thënë se ai nuk do ta vrasë". Bennett ka thënë së gjatë

ndërmjetësimin të tij, Putini ka hequr dorë nga kërkesa për çarmatosje të Ukrainës dhe Zelensky ka hequr dorë nga anëtarësimi i vendit të tij në NATO.

Bennet, një lider kryesisht i patestuar - meqë ka qëndruar në pushtet për gjashtë muaj - e ka zhytur veten në diplomaci ndërkombëtare pak pas nisjes së luftës për shkak të lidhjeve që ka Izraeli me Rusinë dhe Ukrainën.

Izraeli ka lidhje të mira me Kremlinin dhe i konsideron ato si strategjike kur ka kërcënime nga Irani, mirëpo mban anën e kombeve perëndimore dhe tenton të tregojë mbështetje edhe për Ukrainën.

Sudani Jugor: Papa bën thirrje që njerëzit ta refuzojnë "helmin e urrejtjes"

XHUBA, 5 SHKURT - Papa Françesku e ka përfunduar pelegrinazhin e paqes në Sudanin Jugor, duke organizuar një meshë të hapur për mijëra pjesëmarrës. Ai i ka bërë thirrje masës që të refuzojë atë që e ka konsideruar "helm të urrejtjes" dhe u ka kërkuar pjesëmarrësve që të mos humbin mundësitë për të

ndërtuar paqe. Ai është zotuar se do të fokusohet me liderët shtetërorë drejt dhënies fund të konfliktit. Para largimit, ai i ka thënë turmës: "Të dashur vëllezër dhe motra, kthehem në Romë duke ju ndier më afër zemrës sime".

Katolikët e entuziazmuar kanë thënë për agjencinë e lajmeve "Reuters" se kjo vizitë i ka

gëzuar ata jashtë mase. "Nuk kam fjetur, jam shumë e lumtur", ka thënë Jovana Buyom. "Ne jemi shumë të lumtur me ardhjen e Papës, sepse ai na ka dhënë mesazhin e paqes, të bashkohemi ne populli i Sudanit Jugor", ka thënë Juaj Bol Ayuel. Mesha e Papës ka mbledhur 70 000 pjesëmarrës.



Kurti takon Erdoganin



PRISHTINË, 5 SHKURT - Me ftesë të presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ambasadori i Kosovës në Turqi, Agon Vrenezi dhe ish-kryetari i komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, zhvilluan një vizitë pune në Stamboll. Gjatë qëndrimit njëditor në

Turqi, kryeministri Kurti pati një takim me presidentin Erdogan dhe një darkë pune të përbashkët me delegacionet përkatëse. U bisedua për lidhjet ndërmjet dy popujve, raportet miqësore ndërmjet dy vendeve dhe për mënyrat se si mund t'i thellojmë e forcojmë ato. Gjithashtu, u diskutua edhe për mundësitë e reja të bashkëpunimit me qëllim të rritjes së tij në rrafshin

ekonomik e tregtar dhe të sigurisë e mbrojtjes. Kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen e tij dhe të popullit të Kosovës për mbështetjen e pakursyer të Turqisë përgjatë gjithë etapave të ndërtimit të shtetit të Kosovës dhe zhvillimit të tij, sikurse shprehu edhe falënderimin për përkrahjen e Turqisë për anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe Këshillin e Evropës.

Boshnjakët dhe shqiptarët në Serbi kërkojnë reciprocitet të të drejtave

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe këshilltaren politike, Ardita Sinani, pritën përfaqësues politikë të komunitetit boshnjak e shqiptar që jetojnë në Serbi. Nga delegacioni i SDA Shanxhak, që kryesohej nga kryetari dr. Sulejman Ugljanin, i shoqëruar nga kryetari i PVD, Shaip Kamberi, dhe dy deputetët e tjerë në Kuvendin e Serbisë, Enis Imamovic dhe Selma Kucevic, kryeministri Kurti u njoftua për brengat dhe problemet me të cilat ata ballafaqohen. Me përfaqësuesit boshnjakë dhe shqiptarë u diskutua edhe për elementet përbërëse të propozimit evropian për normalizim të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Të drejtat e komuniteteve joshumicë në shtetet tona pasqyrojnë demokracinë dhe zhvillimin tonë si shoqëri. Për dallim nga Serbia që nga Freedom House klasifikohet si shtet me regjim hibrid, Republika e Kosovës është shtet demokratik me të drejta dhe liri për të gjithë", theksoi kryeministri Kurti. Ai shtoi se komunitetet e ndryshme pa dallim duhet të trajtohen në



kuadër të principeve universale e në harmoni të plotë me standardet e Bashkimit Evropian. Tre deputetët në Kuvendin e Serbisë që pranojnë Kosovën e pavarur, Enis Imamovic, Selma

Kucevic dhe Shaip Kamberi, së bashku me dr. Sulejman Ugljanin, potencuan që janë të pakënaqur me statusin e boshnjakëve dhe shqiptarëve në përgjithësi e posaçërisht në

komunat e Novi Pazarit, Tutinit e Sjenicës në Sanxhak si dhe të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit në Luginë. Ata kërkuar reciprocitet të të drejtave me serbët në Republikën e Kosovës.

U pajtuan se për paqe të qëndrueshme dhe siguri në Ballkanin Perëndimor duhet të ketë simetri të drejtash dhe jo qasje privilegjuese ndaj një pakice apo komuniteti.

Lajçaku viziton Kosovën

PRISHTINË, 5 SHKURT - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Mirosllav Lajçak, pritet që të hënën t'i vizitojë Kosovën dhe Serbinë, sipas burimeve diplomatike të Radios Evropa e Lirë. As këtë herë nuk janë treguar hollësitë e vizitës vetëm se ai do të diskutojë me bashkëbiseduesit për hapat e ardhshëm të dialogut, sidomos për avancimin rreth propozimit evropian për normalizimin e marrëdhënieve mes palëve, por edhe për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut. Lajçaku e ka vizituar Kosovën 10 ditë më parë, kur ka zhvilluar një darkë pune me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe kryenegociatorin e



Kosovës në dialog me Serbinë, kryediplomatit e BE-së, Jozep Borell, kanë përshëndetur publikisht qëndrimet e presidentit serb Aleksandar Vuçiq për propozimin e BE-së.

kryediplomatit e BE-së, Jozep Borell, kanë përshëndetur publikisht qëndrimet e presidentit serb Aleksandar Vuçiq për propozimin e BE-së.

Këtë plan të BE-së e përkrahin plotësisht edhe Shtetet e Bashkuara, andaj Kosova dhe Serbia janë ftuar disa herë që jenë konstruktive në qasjen ndaj këtij propozimi. Propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë u është dorëzuar Kosovës dhe Serbisë në fund të verës, por përmbajtja e tij nuk është bërë publike. "Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje në një version të tij, ku nuk përmendet njohja reciproke mes dy vendeve, por përkushtimi i tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruuese. Në të njëjtën kohë, Kosovës është duke iu shtruar trysnia për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë

Serbe. Mekanizmi ndërkombëtar beson se Kosova e ka marrë këtë obligim në kuadër të marrëveshjeve të Brukselit dhe duhet zbatuar. Kryeministri Kurti më 2 shkurt i ka paraqitur gjashtë kushte për themelimin e Asociacionit, por BE-ja nuk i ka komentuar ato. Sipas Kurtit, Asociacioni nuk mund të jetë njëetnik, ai duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, të ketë një emër tjetër dhe të mos ketë kompetenca ekzekutive, të ketë të përfshirë parimin e reciprocitetit mes shteteve sa iu përket të drejtave të pakicave kombëtare, bazuar në modelet evropiane. Vuçiqi, në anën tjetër, i ka konsideruar këto kushte si "përralla".



Hyseni: 'Grupi i Tiranës' në LV dëshiron konfrontim Kosovë - ShBA, opozita të mos qëndrojë indiferente

Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, ka drejtuar kritika ndaj të ashtuquajturit "Grupi i Tiranës" në Lëvizjen Vetëvendosje. Ai ka thënë se ka kohë që ky grup, përpos politikave të LV-së, dikton edhe politikat qeverisëse në Kosovë. "Krijimi dhe etablimi i politikave antiamerikane dhe antiperëndimore duket të jetë misioni i këtij 'Grupi' që ka për qëllim vënien e Kosovës në raporte konfrontuese me ShBA-në dhe BE-në", ka theksuar Hyseni, duke i bërë thirrje opozitës të mos qëndrojë indiferente ndaj këtyre përpjekjeve dhe politikave të këtij grupi

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 SHKURT - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, ka drejtuar kritika ndaj të ashtuquajturit "Grupi i Tiranës" në Lëvizjen Vetëvendosje, duke thënë se kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka bërë mirë që e ka riaktualizuar tendencën e këtij "grupi" për "qëndrime antiamerikane dhe antiperëndimore". Hyseni në një postim në "Facebook" ka shkruar se ky grup po dikton politikat qeverisëse në Kosovë. "Vetëvendosja dhe politikat anti-amerikane e anti-perëndimore të 'Grupit të

Tiranës'. Ka kohë që i ashtuquajturit 'Grupi i Tiranës' përpos politikave të LV-së dikton edhe politikat qeverisëse në Kosovë. Krijimi dhe etablimi i politikave antiamerikane dhe anti-perëndimore duket të jetë misioni i këtij 'Grupi' që ka për qëllim vënien e Kosovës në raporte konfrontuese me ShBA-të dhe BE-në. Diçka që kishte filluar diku në vitin 2015, duket se është konsoliduar fort në politikat partiake të LV-së dhe ato të qeverisë Kurti. Abdixhiku bëri mirë që e riaktualizoi këtë tendencë. Është detyrë e forcave politike opozitare në Kosovë të mos qëndrojnë indiferent ndaj këtyre përpjekjeve dhe politikave

të këtij 'Grupi'", ka shkruar Hyseni.

Ai ka treguar se në vitin 2016 tre eksponentë të këtij "Grupi" u patën deportuar nga Kosova me vendim të Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj, sepse kishin shkelur ligjin për qëndrim në Kosovë. "Në atë kohë unë isha ministër i Punëve të Brendshme. Drejtoria për Migrim dhe të Huaj kishte kryer punën e vet në pajtim me ligjet në fuqi pa asnjë ndërhyrje politike. Sidoqoftë, pak kohë më vonë LV-ja e cila e thoshte se 'ishte deportim politik', organizoi një sulm të turpshëm ndaj meje, në kohën time të lirë, ndërsa po lëvizja në veturën time private. Më 22 korrik 2016, ndërsa po ngisja veturën time private, një grup i LV-së, të cilët u identifikuan më vonë, por çuditërisht, u liruan nga gjykata, hodhën ngjyrë në xhamin e përparme të veturës. Si pasojë, nga pamundësia e pamjes për të drejtuar automjetin tim nga ngjyra e hedhur, vetura ime në lëvizje u aksidentua me dy vetura tjera. Pak orë më vonë, me një komunikatë, Vetëvendosja mori përgjegjësinë për sulmin ndaj meje. Dhe prap, çuditërisht, asnjë veprim ligjor nuk u

ndërmor kundër LV-së, ndonëse sulmi kishte vë në rrezik jetë njerzish! Pasi një indiferencë e pashpjegueshme. Nuk kishte asnjë reagim apo dënim të këtij sulmi ndaj ministrit të brendshëm, qoftë edhe nga një deputet i vetëm i Kuvendit të Kosovës. Ishte vetëm kryeministri Isa Mustafa që kishte dënuar sulmin. Pse e bëra këtë digresion? Assesi jo për t'u viktimizuar!

E bëra thjeshtë për të vënë në pah dhe për të theksuar se e keqja vetëm sa vjen e trashet nëse nuk i ndërpritet rruga me kohë. Apo siç thoshte Nelson Mandela: "Budallenjtë shumohen kur njerëzit e mençur heshtin", ka theksuar ish-ministri Hyseni.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë në emisionin "Pressing" në T7 se brenda LV-së ekziston një "Grup i Tiranës" që dikton politikat e këtij subjekti i cili është në pushtet në Kosovë. Sipas Abdixhikut, ky grup ka për qëllim të krijojë politika anti-amerikane dhe ka kërkuar nga institucionet e sigurisë t'i hetojë. "Shpjegim nuk kam sikurse Grupi i Tiranës që bën politikat shtetërore të

Kosovës. Grupi i Tiranës që ka mision politik largimin e Kosovës nga rruga proamerikane. Ideologët e LV-së që bëjnë luftë hibride dhe paraqesin shtyllat identitare të programit qeveritar dhe ia shkruajnë fjalimet të gjithë grupit parlamentar të LV-së. Ato fjalime e mesazhe politike ndaj aleatëve të Kosovës. Po t'i dëgjosh ata, ShBA-ja është shitur. U kërkoj institucioneve të vendit që ta bëjnë verifikimin e tyre pasi misioni i tyre është të prishen marrëdhëniet me partnerin tonë kryesor", ka thënë ai.

Më tutje, ai ka thënë se nuk ka asgjë kundër Shqipërisë, për të cilën është kritikuar nga eksponentë të pushtetit, por vetëm kundër këtij grupi brenda LV-së. "Po flas për një grup të Tiranës që familjet i mban jashtë Kosovës dhe vjen si parashutist e bën politika antikombëtare, antishqiptare dhe antiamerikane. Po bëj thirrje për herë të tretë sot. Po flas për këta, e po mundohen të më bëjnë si politikan kundër Shqipërisë. Jo, kjo nuk qëndron. Unë me Edi Ramën dhe Sali Berishën kam raporte shumë të mira. Ne bisedojmë", ka theksuar Abdixhiku.

Incidenti i djegies së Kuranit bllokoi rrugën e Suedisë drejt NATO-s



Stokholm, 5 shkurt - Planet e Suedisë, por edhe Finlandës, për t'u anëtarësuar shpejt në NATO, kanë hasur në pengesa. Turqia - si vend anëtar i aleancës me të drejtë vetoje - ka shtyrë për kohë të pacaktuar bisedimet e anëtarësimit, pasi një politikan i ekstremit të djathtë në Suedi ka djegur një kopje të Kuranit - librit të shenjtë islamik - jashtë Ambasadës turke në Stokholm më 21 janar. Në lejen që Rasmus Paludan ka marrë nga policia është thënë se protesta e tij është "kundër Islamit" dhe "kundër përpjekjeve të presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan për të ndikuar lirinë e shprehjes në Suedi".

Incidenti ka shkaktuar zemërim dhe protesta gjetkë në botën myslimane, ndërsa Erdogani ka porositur Suedinë të mos presë mbështetje nga Turqia për anëtarësim në NATO. "Nëse vërtet i respektoni të drejtat dhe liritë, duhet të respektoni edhe Republikën e Turqisë ose besimet fetare të myslimanëve. Nëse nuk e tregoni këtë respekt, më vjen keq, ju nuk do të keni mbështetje nga ne për anëtarësim në NATO", ka thënë Erdogan.

Suedia dhe Finlanda, me dekada, kanë qenë ushtarakisht neutrale. Por, lufta e Rosisë në Ukrainë ka ndryshuar pikëpamjet e tyre për sigurinë.

Finlanda ka një kufi prej 1.300 kilometrash me shtetin rus, ndërsa ishulli suedez i Gotlandit gjendet vetëm 300 kilometra larg enklavës ruse të Kaliningradit, ku edhe është e pozicionuar Flota Baltike e Rosisë. Kështu, të dyja vendet - me ushtri relativisht të forta - e kanë parë NATO-n si mekanizmin më të mirë për garantimin e sigurisë së tyre. Ato kanë aplikuar bashkërisht për anëtarësim në maj të vitit të kaluar.

Nga 30 vendet anëtare, deri më tash vetëm Turqia dhe Hungaria nuk e kanë ratifikuar hyrjen e tyre në aleancë, megjithëse Budapesti ka premtuar se do ta bëjë këtë në fillim të këtij viti.

Turqia, qysh në fillim, ka qenë kundër anëtarësimit të tyre në NATO, duke i akuzuar dy vendet nordike për strehimin e militantëve kurdë që kërcënojnë shtetin turk. Stokholmi dhe Helsinki i kanë hedhur poshtë akuzat. Megjithatë, në muajin qershor, së bashku me Ankaranë, ata kanë nënshkruar një marrëveshje trepalëshe që adresonte disa nga shqetësimet e Turqisë.

Është dukur se kjo marrëveshje po i hapte rrugë zgjerimit të aleancës 74-vjeçare, por gjërat, me sa duket, janë bllokuar sërish. Suedia e ka dënuar incidentin me djegien e Kuranit, duke thënë se "provokimet islamofobike janë të tmerrshme". Por, ministri i saj i Jashtëm, Tobias Billstrom, ka shkruar në Twitter se "Suedia ka një liri të madhe të shprehjes dhe kjo nuk do të thotë se qeveria suedeze ose unë i mbështesim mendimet e shprehura".

Analistët në Suedi thonë se nga bllokada turke përfiton vetëm presidenti rus Vladimir Putin. Sipas tyre, Suedia i ka adresuar shumicën e shqetësimeve të Turqisë dhe liria e shprehjes nuk mund të ndërlihet me çështje të sigurisë. Për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë" flet ish-diplomati suedez Michael Sahlin i cili ka shërbyer ambasador edhe në Turqi: "Kemi ardhur në fund të rrugës. Ne i kemi plotësuar - ndoshta edhe më shumë seç duhet - nevojat e Turqisë dhe tani i takon Turqisë të vendosë". "Në një vend liberal natyrisht se do të keni djegie të Kuranit apo kukulla që portretizojnë Erdoganin të varur

në rrugë. Ne nuk mund t'i ndalojmë këto. Mund të mos i pëlqejmë, të shprehim zemërim si qeveri, por nuk mund të ndalohen. Dhe, kjo vlen për secilin vend të NATO-s që e përshkruan veten si liberal dhe demokratik", thotë Sahlin.

Në Turqi disa analistë thonë se prapa bllokadës turke për Suedinë mund të fshihen edhe motive të tjera. Senem Aydin Duzgit, profesoreshë e marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Sabancı në Stamboll, shpjegon për "Exposenë": "Natyrisht se Turqia po përpiqet të fitojë diçka në këmbim dhe këtë [bllokadë] e shfrytëzon si levë. Deklarimi zyrtar qëndron, por nuk mendoj se ky është krejt rrëfimi. Po ashtu, mendoj se Turqia po përpiqet t'i balancojë marrëdhëniet e saj me Rusinë dhe me Perëndimin. Duke vepruar kështu, ajo luan deri-diku edhe në favor të interesave ruse. Turqia, gjithashtu, e sheh në interesin e saj që Rusia të vazhdojë ta mbështesë regjimin aktual turk, sidomos tani para zgjedhjeve. Pra, mendoj se kjo situatë lidhet edhe me politikën e brendshme", thotë Duzgit.

E pyetur nëse Erdogani po i vë interesat e tij politike përpara sigurisë së NATO-s, Duzgit thotë se politika e jashtme turke, sot për sot, lufton për mbijetesën e regjimit. Sipas saj, sistemi aktual politik ka nevojë edhe për legjitimitet të brendshëm, edhe për mbështetjen e aktorëve të jashtëm, përfshirë atë të Putinit. Zgjedhjet e përgjithshme në Turqi do të mbahen në qershor. Duzgit pret që bllokada për Suedinë të mbetet së paku deri në atë kohë. Por, çfarë do të thotë kjo për sigurinë kolektive? Përgjigjet Duzgit: "Natyrisht se krijon vështirësi. Por, në aspektin

formal nuk ka shumë alternativa. NATO-ja nuk mund të përjashtojë asnjë vend. Nuk mund ta përjashtojë Turqinë. Për më tepër, ajo është ushtria e dytë më e madhe në NATO". "Edhe NATO-s i konvenon ta ketë Turqinë jo vetëm për shkak të kontributit ushtarak... Por, nëse Turqinë nuk e ke në NATO, ajo mund të futet gjithnjë e më shumë në orbitën ruse. Kjo do të ishte edhe më e rrezikshme", thotë Duzgit.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka kritikuar qëndrimin e presidentit turk ndaj Suedisë dhe ka kërkuar nga ai që të mos e blloktojë anëtarësimin e saj në NATO. Duke komentuar incidentin në Stokholm, Stoltenbergu ka thënë se "liria e shprehjes është e çmuar në Suedi dhe në të gjitha vendet e tjera të NATO-s".

NATO-ja është zotuar se do të mbrojë çdo cep të territorit të saj përballë agresionit rus. Traktati i NATO-s ka Nenin 5, i cili thotë se sulmi në një vend anëtar të NATO-s nënkupton sulm kundër të gjithëve dhe, rrjedhimisht, nxit përgjigje kolektive.

Rusia pretendon se zgjerimi i NATO-s kërcënon sigurinë e saj dhe ka kërcënuar se do të hakmerret nëse aleanca ushtarake u afrohet edhe më shumë kufijve të saj.

Ish-diplomati suedez Michael Sahlin thotë se siguria në vendin e tij "është relative". "Nëse pranoheni de facto prej së paku 28 vendeve anëtare të NATO-s, kjo do të thotë shumë sa iu përket garancive de facto të sigurisë. Kjo na bën të themi: po, ndihemi më të sigurt se verën e kaluar. Por, kjo nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Ukraina na tregon se ka një diferencë të madhe midis të qenët partner dhe të qenët anëtar i plotë i

NATO-s, thotë Sahlin.

Erdogano i ka dhënë edhe një goditje tjetër Suedisë këtë javë, duke thënë se qeveria e tij mund ta miratojë aplikimin e Finlandës për anëtarësim në NATO pa fqinjin e saj nordik. Gjatë një fjalimi në Ankara, Erdogano ka thënë se Suedia do të tronditet nga ky mesazh dhe e ka porositur Finlandën që të mos e bëjë, siç është shprehur, gabimin e njëjtë si Stokholmi.

Teknikisht, Finlanda do të mund të anëtarësohej në NATO pa Suedinë. Megjithatë, do të ishte e vështirë për NATO-n ta mbronte Finlandën pa qasje strategjike tokësore nëpërmjet Suedisë. Të dyja vendet janë zotuar se anëtarësimi i përbashkët do të jetë prioritet për to.

Ministri i Jashtëm i Finlandës, Pekka Haavisto, ka thënë se vendi i tij do të shqyrtojë një rrugë tjetër vetëm nëse anëtarësimi i Suedisë bllokohet përgjithmonë nga Turqia.

Opozita në Turqi është e larmishme dhe përmban shumë parti, por është shprehur në favor të zgjerimit të NATO-s me Suedinë dhe Finlandën. Profesoresha Duzgit, nga Universiteti Sabancı në Stamboll, thotë se është vështirë të parashikohet rezultati i zgjedhjeve, marrë parasysh se Turqia, sipas saj, ka një qeveri autoritare e cila i kontrollon institucionet.

Por, pavarësisht prej kësaj, zyrtarë të lartë të NATO-s kanë shfaqur shpresën se Ankaraja do ta lejojë Stokholmin dhe Helsinkin t'i bashkohen NATO-s në samitin e ardhshëm të aleancës që do të mbahet në Lituani në mes të korrikut.

NATO-ja për herë të fundit është zgjeruar në vitin 2020, duke pranuar Maqedoninë e Veriut në radhët e saj.

Molliqaj: Për a kundër Asociacionit, të bëhemi bashkë!

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj ka thënë se nocioni i monoetnicitetit për Asociacionin, u lansua nga qeveria për t'u dukur se e përmirësoi statutin e tij. Molliqaj në "Facebook" ka shkruar se versioni final i Asociacionit dihet dhe se i njëjti nuk do të jetë monoetnicitet. "Ky nocioni i monoetnicitetit u lansua nga qeveria për t'u dukur se e përmirësoi statutin e Asociacionit, e versioni final, dihet, nuk ka me qenë mono. Kurrë nuk ka pas me qenë. As atëherë kur kundërshtoj me protesta e aksione brenda

Kuvendit. Asociacioni është i dëmshëm tashmë në secilin version. Si i tillë, absolutisht i papranueshëm. Strategjia është kjo: shpikje problemin, luftoje atë dhe shpalle suksesin. E tërë kjo pjellë e imagjinatës (së rrezikshme). Qeveria luftën kryesore e ka me mbështetësit e saj. Ka detyrë t'i përgjigjet pyetjes së vështirë: si të duket parimore dhe e drejtë, pa qenë e tillë. Kjo e tejkalon temën e asociacionit. Është në pyetje qenia e saj politike", ka shkruar Molliqaj.

Ai ka thënë se këta që krijojnë insinuata dhe kur ato nuk ndodhin (se janë shpikje,

kryesisht duke keqpërdorur situata e gjendje njerëzish) atëherë na japin lajmin e suksesit, se si këta e ndalen, përmirësuan apo ndaluan. "Që të tri deklaratat janë gënjeshtër. Prandaj organizimi për një shoqëri më të barabartë duhet ta tejkalojë konfliktin rreth asociacionit. Edhe ata që janë kundër dhe ata që janë për kanë arsye të fuqishme për t'u bashkuar. Duhet të organizohemi në kundërshtim të gjithë ne që nuk durojmë të qeverisemi me modele politike dogmatike, autoritare", ka shkruar Molliqaj.



Themelohet nëndega e PDK-së në Bassano Del Grappa të Italisë, Reçica: Po zgjerohemi



PRISHTINË, 5 SHKURT - Deputeti dhe anëtari i Kryesisë i PDK-së, Elmi Reçica, së bashku me deputetin Enver Hoxhaj dhe nënkryetaren Vlora Çitaku, ishin në Bassano Del Grappa të Italisë, ku themeluan një nëndegë të kësaj partie. "Së bashku me Vlorën, Enverin dhe Sadriun, të prirë nga kryetari i Këshillit Patriot Krasniqi, në prani të bashkëveprimtarëve dhe atdhetarëve të shquar e të devotshëm, u themelua

Nëndega e Partisë Demokratike të Kosovës në Bassano Del Grappa të Italisë. Me këtë rast kryetari i nëndegës u zgjodh Sahit Topalli, gjithashtu u votua edhe kryesia e nëndegës", ka shkruar Reçica në "Facebook". Ai ka thënë se Partia Demokratike e Kosovës po zgjerohet dhe po fuqizohet në Itali. "Jemi duke punuar vazhdimisht që të jemi sa më afër mërgimtarëve tanë me qëllim të përfaqësimit sa më të

madh të mërgatës sonë në jetën politike dhe bashkërisht të angazhohemi për një Kosovë të zhvilluar dhe një PDK të fortë. Kuvendin e përcollën dhe e përshëndetën duke i dëshiruar punë të mbarë dhe suksese përfaqësuesja e shoqatës 'Zëri i Atdheut', profesoresha znj. Rajmonda Deda, si dhe përfaqësuesi i shoqatës 'Bashkimi Kombëtar', profesor Ragip Thaçi", ka shkruar deputeti Reçica.

Osmani: Është e rrezikshme të kesh një fqinje si Serbia



PRISHTINË, 5 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë një interviste dhënë për të përditshmen kroate "Vecerjnji list", ka thënë se mburret shumë me raportet që Kosova i ka me Kroacinë. Si presidente e Kosovës thotë se në mënyrë aktive është e përfshirë në bashkëpunimin me të gjitha institucionet e Kroacisë për t'i afruar me shumë dy vendet dhe popujt, t'i heqë barrierat në rrugën e bashkëpunimit dhe të

punohet në mirëqenien e dy popujve. Ajo ka folur edhe për situatën në Kosovë, bisedimet me Serbinë dhe provokimet e Aleksandar Vuçiqit dhe pse ajo e kundërshton krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe siç pretendon Serbia të ketë kompetenca ekzekutive. Osmani hodhi poshtë çdo mendim për ndarjen e vendit, duke theksuar se do ta hapte kutinë e Pandorës dhe njoftoi

një vizitë zyrtare në Kroaci së shpejti. "Situata në Kosovë është jashtëzakonisht e tensionuar, negociatat disi kanë ngecur, nuk ka dinamikë. Megjithatë, kohët e fundit Miroslav Lajçak dhe Gabriel Escobar mbërritën dhe njoftuan një raund të ri bisedimesh. Është e rrezikshme të kesh një fqinje si Serbia. NATO-ja dhe forcat tona do t'i parandalojnë skenarët e Vuçiqit", ka thënë Osmani.

FSK-së i shtohen specialistët e qitjes

PRISHTINË, 5 SHKURT - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka njoftuar se po shtohen operatorët specialistë për qitje të mprehtë në FSK. Në "Facebook" ai ka shkruar se në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes po realizohen trajnimet, ku edhe trajnimi specialistik për qitje të

mprehtë u realizua me sukses të lartë. "Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes po realizohen trajnimet në përputhje me misionin dhe konceptin bashkëkohor të profesionalizmit të kuadrove tona në të gjitha profilet. Edhe trajnimi dyjavor specialistik për qitje të mprehtë u realizua

me sukses të lartë, si në pjesën teorike ashtu edhe atë praktike në qitje në kushte të ndryshme atmosferike. Efektiviteti shumë i lartë i treguar në qitje është dëshmi se komandot tona janë të përgatitur vetëm për fitore në çdo operacion", ka shkruar Mehaj.



15.5 milionë euro më shumë të hyra për muajin janar

PRISHTINË, 5 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se muaji i parë i këtij viti ka reflektuar me të hyra të konsiderueshme tatimore, që nënkupton se është një nismë e mbarë për realizimin e projeksionit për këtë vit. "96.7 milionë euro tatime janë të hyrat e muajit janar që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të

kaluar kemi rritje për 15.5 milionë euro apo 19.2 për qind, ndërsa kontributet pensionale janë 18 milionë euro", ka njoftuar ATK-ja. Administrata Tatimore e Kosovës ka bërë me dije se këtë vit, përveç prioriteteve kryesore që ka në mbledhjen e të hyrave, borxheve dhe vazhdimin e avancimit të shërbimeve profesionale për tatimpagues,

ka synim edhe implementimin e planit strategjik, implementimin e projekteve për përmirësimin e përmbushjes në sektorët me rrezik etj. "ATK falënderon tatimpaguesit për kryerjen e detyrimeve tatimore, në të njëjtën kohë kërkon nga ta të vazhdojnë të jenë kontribuues në zhvillimin e vendit tonë", ka njoftuar ATK-ja.



Evropa ndalon naftën ruse lidhur me agresionin në Ukrainë

BRUKSEL, 5 SHKURT - Bashkimi Evropian ka filluar të zbatojë një vendim për ndalimin e importit të naftës që vjen nga Rusia. Duke filluar nga dita e diel, 27 vendet e Bashkimit Evropian kanë ndërmarrë hapin për ta ulur më tej varësinë e tyre energjetike nga Moska.

Ky hap synon t'i ulë të ardhurat që siguron Kremlinin nga karburantet fosile si ndëshkim lidhur me agresionin e tij në Ukrainë.

Ndalimit i shtohet një tjetër masë e ndërmarrë së fundmi

për t'i vendosur një tavan çmimit të naftës ruse, për të cilin u ra dakord nga Grupi i Shtatëshes.

Qëllimi është lejimi i naftës ruse që të vazhdojë të rrjedhë në vende si Kina dhe India, por të shmangë një rritje të papritur të çmimeve që do t'i dëmtonte konsumatorët në mbarë botën, njëkohësisht do t'i reduktonte fitimet që financojnë luftën.

Evropa duhet të gjejë burime të tjera për t'u furnizuar me karburant duke përfshirë SHBA-në, Lindjen e Mesme dhe Indinë.



Bashkim Nurboja zgjedhet kryetar i Bordit të BQK-së



PRISHTINË, 5 SHKURT - Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) ka zgjedhur kryetar të saj Bashkim Nurbojan. Sipas një njoftimi, bëhet me dije se gjatë mbledhjes së mbajtur të premtën Bordi u njoftua edhe për raportin mujor të Guvernatorit/Bordit Ekzekutiv. "Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2023, mori vendimin si

në vijim: Bashkim Nurboja është zgjedhur kryetar i Bordit të Bankës Qendrore. Gjithashtu, Bordi u njoftua me raportin mujor të Guvernatorit/Bordit Ekzekutiv", thuhet në njoftim. Sipas Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga guvernatori dhe katër (4) anëtarë joekzekutivë, të cilët ngarkohen me detyrën e aprovimit dhe mbikëqyrjes së

zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe të aktiviteteve të Bankës Qendrore.

Ditë më parë Banka Qendrore e Kosovës i ka dërguar në Qeveri dhe Kuvend edhe emrat për përzgjedhjen e guvernatorit të ri. Sipas BQK-së, pas përfundimit të veprimeve procedurale, në listën e kandidatëve janë Ahmet Ismaili, Nexhat Kryeziu, Lulzim Ismaili dhe Shkëndije Himaj.


Tahiri: Mbi 80 për qind e investimeve në Trust kanë humbur për vitin 2022

PRISHTINË, 5 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka publikuar disa shifra për pasqyrat e Fondit të Kursimeve Pensionale (Trusti). Tahiri në "Facebook" ka shkruar se mbi 80 për qind e investimeve në Trust për vitin 2022 kanë humbur. "Këtë javë pranuar pasqyrat individuale të Trustit Pensional dhe për habi pothuajse i gjithë kontributi i këtij viti, më saktë mbi 80 për qind e investimit për vitin 2022 ka humbur. Nga një analizë e thjeshtë vërehet se rreth 6 për qind e kontributit total ka humbur vetëm gjatë vitit që lamë pas", ka shkruar Tahiri.

Tahiri ka shtruar edhe një pyetje për kryeministrin Kurti. "Dhe tani kam një pyetje për kryeministrin Kurti: A keni fije turpi kur vendosët që t'i privonit qytetarët e Kosovës që në këtë kohë krize të paparë të tërheqin një pjesë të kursimeve të tyre. Ku mbeti arsyetimi juaj kur thoshit se po i mbrojmë investimet e qytetarëve, kur sot u vërtetua se gati i gjithë kontributi i vitit 2022 rezultoi me humbje si rezultat i paaftësisë tuaj? E keni 'helmuar' popullin me pollavra, me tema koti, përderisa ekonomia është para bankrotimit e sektori publik para kolapsit, ju bëni filma! Boll ma!", ka shkruar Besnik Tahiri.



Historia nacionaliste



Nga: Daut DAUTI

Para disa ditësh e postova një shkrim të shkurtë ku shihej ndihma e ushtrisë serbe që ia ofroi Perandorisë Otomane në Betejën e Nikopolit. Disa ditë më vonë, Koha Ditore e botoi një përshkrim të një punimi që e kishte botuar Oliver Schmitt, i cili e kishte thënë të njëjtën gjë, por në mënyrë më të gjerë. Por, kjo që e kishte thënë Schmitt e mori dhenë ndër shqiptarët se ai është historian i huaj. Kjo gjë nënkupton se shqiptarët më shumë iu besojnë historianëve të huaj dhe ndoshta këtu ekziston një arsye. Por, Schmitt nuk thoshte asgjë që nuk e kanë thënë historianët tjerë (të mirëfilltë) para tij. Ky punim i Schmitt-it u përhap me qëllim që të demantohet se serbët nuk e kanë mbrojtur 'Evropën e Krishterë' nga 'sulmet barbare turke', siç kanë trumbetuar gjithmonë. Kjo është një teori jo vetëm e serbëve, por e tërë popujve ballkanikë. Historia e tërë

këtyre popujve (shqiptar, rumun, grek, bullgar ...) e thotë po këtë gjë, e cila nuk është e vërtetë. Këto vende kanë aplikuar narracionin, gati fantastik, për ta ndërtuar historinë nacionaliste me të cilën sot mendojnë se duhet t'i vardisen Evropës.

Por, realiteti ka qenë ndryshe. Nuk janë vetëm serbët që e ndihmuan zgjerimin e Perandorisë Otomane. E kanë ndihmuar të gjithë popujt e Ballkanit. Natyrisht, fillimisht kanë rezistuar, por kur kanë rënë nën sundim, më nuk kanë lëvizur aq shpesh kundër pushtetit, siç e paraqesin sot historitë e tyre kombëtare. Në realitet, vendet ballkanike, jo që janë bërë vetëm pjesë e perandorisë, por e kanë prodhuar edhe klasën sunduese otomane.

Ja disa Vezirë (kryeministra) të Perandorisë Otomane që kanë shërbyer nga viti 1453 deri më 1474:

1. Çandarli Halil Pasha ishte nga familja e njohur 'turke'

në Azi të Vogël, të cilin e ekzekutoi Sulltan Mehmeti II në vitin 1453. Çandarli Halil Pasha e mbronte idenë se 'nuk duhet ta okupojmë Konstantinopolin se prishemi me Evropën', frazë të cilën nuk dëshironte ta dëgjonte Sulltan Mehmeti ambicioz. Me këtë akt Sulltan Mehmeti i dha fund ndikimit turk në perandori dhe e forcoi atë otoman.

2. Pastaj Sulltan Mehmeti në pushtet e solli mësuesin e tij të aftësive ushtarake dhe të edukatës, Zaganos Pashën, i cili quhej edhe Zognush Pasha dhe dihet që ishte shqiptar, siç tregon edhe emri.

3. Pastaj vjen Mahmud Pasha Angeloviq, serb i lindur në Novo Bërdë (Kosovë), i cili zëvendësohet nga (4.) Rum Mehmed Pasha, që ishte grek.

5. Pas Rumi vjen Ishak Pasha, që ishte shqiptar ose grek.

6. Gjedik Ahmed Pasha për të cilin thuhet se ka qenë shqiptar, por më shumë ka gjasa të ketë qenë serb ose grek. Studimet më të reja të disa historianëve serbë

thonë se ishte nga një fshat afër Vranjës.

7. Karamanli Mehmet Pasha vinte nga familja e Rumi (poeti dhe filozofit të njohur), pra ishte persian.

8. Pastaj erdhi Daut Pasha që ishte shqiptar.

9. Hersekli Ahmed Pasha që emri i tij i mëparshëm ishte Stjepan Hercegoviq. Pra, ishte nga Bosnja dhe nga kjo, serb ose kroat.

Dhe, kështu vazhdon lista e kryeministrave otomanë me origjinë greke, serbe, shqiptare, bullgare, boshnjake, armene, gjeorgjiane etj. Në të shumtën e rasteve, po këtë përbërje e kishte edhe ushtria otomane.

Tashti të kthehemi te Sulltan Mehmeti II. Nuk është i vogël numri i historianëve që pohojnë se nëna e tij ishte shqiptare. Por, ajo që është tejet e sigurt është se gruaja e tij ishte shqiptare. Mehmetin e trashëgoi i biri, Sulltan Bajaziti II, i cili, nëse flasim me terma etnologjik, ishte shqiptar 100 për qind pasi që edhe nënën edhe babën i kishte të tillë. Por,

këta dy ishin ata që përfundimisht i nënshtuan territoret shqiptare.

Kur në vitin 1459 Serbisë iu hoq statusi i vasalitetit, dhe kur ky vend ra plotësisht nën sundimin otoman,

kryeministër i perandorisë ishte Mahmut Pashë Angeloviqi, i cili, si shtesë, ishte i martuar me vajzën e Zognush Pashës. Pra, e kishte gruan shqiptare. Gruaja e tij, njëkohësisht, ka qenë edhe dashnore e një shqiptari tjetër, Mustafës, djalit të sulltan Mehmetit. Sidoqoftë, luftës për nënshtim të Serbisë dhe Bosnjës i priu personalisht Mahmut Pashë Angeloviqi.

Pra, 'erdhi turku dhe ...'. Jo, nuk erdhi turku hiq. Erdhën shqiptarët, grekët, serbët, boshnjakët, bullgarët, rumunët, hungarezët, ukrainasit ... Këta ishin Perandoria Otomane, klasa sunduese e të cilës u ndërtua përmes sistemit të Devshirmes. Këta popuj kanë dhënë kastën e Jeniçerëve, shtresën sunduese dhe njësinë elitare ushtarake otomane. /Telegrafi/

Mitologjia greke, bota që zëvendësoi frikën me bukurinë

Bota e mitologjisë greke nuk ishte një vend terrori për shpirtin e njeriut. Është e vërtetë që perënditë ishin të paparashikueshme. Nuk mund ta dije se ku do të godiste rrufeja e Zeusit. Megjithëkëtë, të gjitha hyjnitë kishin një bukuri njerëzore, dhe asgjë që ka bukuri njerëzore nuk mund të jetë e frikshme. Shkrimtarët e hershëm të mitologjisë greke, transformuan një botë të mbushur me frikë, në një botë të mbushur me bukuri

Grekët, ndryshe nga egjiptianët, i krijuan perënditë e tyre sipas imazhit të vet.

Përse ndodhi, apo kur, për këtë nuk kemi asnjë ide. Ne dimë vetëm që tek poetët më të hershëm të Greqisë, lindi një pikëpamje e re, e cila as nuk ishte ëndërruar kurrë në botën para tyre, por as nuk e la kurrë botën pas tyre. Me ardhjen e Greqisë, njerëzimi u bë qendra e Universit, gjëja më e rëndësishme e tij. Ky ishte një revolucion i mendimit. Deri atëherë, qeniet njerëzore pak rëndësi kishin patur. Me Greqinë, njeriu kuptoi fillimisht se çfarë ishte njerëzimi.

Grekët i bënë perënditë, sipas imazhit të tyre. Kjo nuk ishte futur kurrë më parë në mendjen e njeriut. Deri atëherë, perënditë nuk kishin patur fare të ngjashëm në realitet.

Ato ishin ndryshe nga gjithë qeniet e gjalla. Në Egjipt, një kolos i lartë, i palëvizshëm, përtej fuqisë së imagjinatës, i fiksuar në gur njësoj si kolonat gjigande të tempujve, ishte një përfaqësim i formës njerëzore, e cila qëllimisht ishte bërë jonjerëzore. Ose një figurë e ngurtë, një grua me kokë maceje, që linte të kuptohej për mizorinë çnjerëzore. Apo një sfinks monstruoz dhe misterioz, i ftohtë ndaj gjithçkaje të gjallë.

Në Mesopotami, gjejmë basorelievë me forma kafshërore ndryshe nga çdo bishë që është njohur ndonjëherë, njerëz me koka zogjsh dhe luanë me koka demash, të dy me krahë shqiponjash, krijesa të artistëve të cilët që kishin për qëllim të prodhonin diçka që nuk ishte parë kurrë, përveçse në mendjen e tyre, një konsumim i jorealitetit. Këta dhe të ngjashmët e tyre, ishin ata që adhuronte bota para-Greke. Por, mjafton të mendosh për një statujë të një perëndie greke, kaq normale dhe e natyrshme në bukurinë e vet, për të perceptuar se çfarë ideje e re i kishte ardhur botës. Me ardhjen e saj, universi u bë racional.

Shën Pali thoshte se e padukshmja duhet të kuptohet prej të dukshmes. Kjo nuk ishte një ide hebreje, ishte greke. Në botën e lashtë, vetëm në Greqi njerëzit merreshin me të dukshmen: ata e gjenin kënaqësinë e dëshirave të tyre, në atë që shihnin në botën që i rrethonte. Skulptori shihte atletët

që garonin në lojëra dhe ndjente se, asgjë që ai mund të imagjinonte, nuk do të ishte aq e bukur sa ata trupa të fuqishëm. Dhe kështu krijoi statujën e Apollonit. Rrëfimtari gjeti Hermesin mes njerëzve që ndeshte në rrugë. Ai e shihte perëndinë si “një djalë të ri në moshën kur rinia është më e bukur”, siç thotë Homeri. Artistët dhe poetët grekë kuptuan se sa i mrekullueshëm mund të ishte njeriu, i drejtë, i shpejtë dhe i fuqishëm. Ai ishte përmbushja e kërimit të tyre për bukurinë. Ata nuk kishin dëshirë të krijonin ndonjë fantazi, me formën e mendjeve të tyre. I gjithë arti dhe mendimi i Greqisë vërtitej përreth qenieve njerëzore.

Perënditë humane e bënë qiellin një vend të njohur dhe të pëlqyeshëm. Grekët ndiheshin si në shtëpi aty. Ata dinin se ç'bënin atje banorët hyjnorë, çfarë hanin dhe pinin, ku i shtronin banketet dhe si dëfroheshin. Sigurisht që duhej t'ua kishe frikën; ata ishin shumë të fuqishëm dhe të rrezikshëm kur ishin të zemëruar. Gjithësesi, me kujdesin e duhur, njeriu mund të ndihej mirë me ta. Ai ishte madje i lirë të qeshte me ta. Zeusi, që përpiqej të fshihte aventurat e dashurisë nga e shoqja, ishte një figurë qendrore argëtimi. Grekëve u pëlqente edhe më shumë për këtë. Hera ishte një personazh komedie, gruaja tipike xhelozë, dhe marifetet e saj për të futur në siklet të shoqin dhe ndëshkuar rivalët, në vend që t'i mërzisnin grekët, i argëtonin edhe më shumë. Histori të tilla jepnin një ndjesi miqësore. E qeshura në praninë e një sfinksi egjiptian apo një bishe asiriane ishte e pamendueshme, por në Olimp ishte krejt e natyrshme dhe kjo i bënte perënditë shoqëri të mirë. Edhe në tokë, hyjnitë ishin shumë tërheqëse nga pikëpamja njerëzore. Në formën e vashave të bukura ato popullonin pyjet, lumenjtë, detin, në harmoni me tokën dhe ujërat e kristaltë.

Kjo është mrekullia e mitologjisë greke – një botë njerëzish, të çliruar prej frikës paralizuese të një të Panjohure të gjithëpushetshme. Pakuptueshmëritë e tmerrshme që adhuroheshin tjetërkund, dhe shpirtërat e frikshëm me të cilat ishte mbushur toka, ajri dhe deti,



ishin të ndaluara në Greqi.

Mund të duket e çuditshme të thuash se njerëzit që krijuan mitet, nuk pëlqenin irracionalen dhe kishin një dashuri për faktet; por kjo është e vërtetë, sado që fantastike të jenë disa prej historive. Cilido që i lexon më vëmendje, zbulon se gjërat edhe më të paarsyeshme ndodhin në një botë që është në thelb racionale dhe e bazuar në fakte. Herkuli, jeta e të cilit ishte një luftë e gjatë kundër përbindëshave, është thënë gjithmonë se e ka patur shtëpinë në Tebë. Vendi i saktë ku Afërdita lindi nga shkuma, mund të vizitohej nga çdo turist në lashtësi: ndodhej shumë pranë kishullit të Kiterës. Pegasusi, kali me krahë, pasi fluturonte gjithë ditën, kthehej përnatë në stallën e tij në Korinth. Një vendbanim i njohur lokal i bënte rela gjithë qeniet mitike. Nëse kjo përzjerje duket fëmijërore, mendoni pak se sa i arsyeshëm është sfondi, krahasuar me Xhindin që del nga hiçi në llambën e Aladinit, dhe i cili rikthehet tek asgjëja pasi realizon detyrën.

Irracionaletja e tmerrshme nuk ka

vend në mitologjinë klasike. Magjia, kaq e fuqishme në botën para dhe pas Greqisë, është pothuaj joekzistente.

Nuk ka burra dhe janë vetëm dy gra me fuqi të mbinatyrshme të frikshme. Magjistarët dhe shtrigat e liga që vërtiteshin nëpër Evropë dhe Amerikë, madje deri në kohët e fundit, nuk kishin aspak vend në historitë e grekëve. Circe dhe Medea janë të vetmet shtriga dhe ato janë të reja dhe të bukura, jo të frikshme. Astrologjia, që ka lulëzuar qysh prej ditëve të Babilonisë së lashtë e deri sot, mungon tërësisht në Greqinë klasike.

Ka shumë histori për yjet, por asnjë gjurmë të idesë që ata ndikojnë në jetët e njerëzve. Astronomia është ajo që mendja greke krijoi prej yjeve. As edhe një histori e vetme nuk ka një prift magjik, i cili është i tmerrshëm sepse ka disa marifete me të cilat të vërë përfund deri edhe perënditë.

Prifti rrallë shihet dhe nuk është kurrë i rëndësishëm. Tek Odisea, kur një prift dhe një poet bien në gjuhë para Odiseut, duke iu lutur që t'ua kursejë jetën, heroi vret

priftin pa u menduar, por shpëton poetin. Homeri thotë se kishte frikë të vriste një njeri, të cilit perënditë i kishin mësuar artin hyjnor. Jo prifti, por poeti, kishte favorin e hyjnive dhe askush nuk ndihej ndonjëherë i frikësuar prej një poeti. Edhe fantazmat, të cilat kanë luajtur një rol kaq të madh dhe të frikshëm në të tjera vende, nuk shfaqen kurrë në ndonjë histori greke. Grekët nuk kishin frikë prej të vdekurve – “të vdekurit e gjorë”, siç i quante Odiseu.

Bota e mitologjisë greke nuk ishte një vend terrori për shpirtin e njeriut. Është e vërtetë që perënditë ishin të paparashikueshme. Nuk mund ta dije se ku do të godiste rrufeja e Zeusit. Megjithëkëtë, të gjitha hyjnitë kishin një bukuri njerëzore, dhe asgjë që ka bukuri njerëzore nuk mund të jetë e frikshme. Shkrimtarët e hershëm të mitologjisë greke, transformuan një botë të mbushur me frikë, në një botë të mbushur me bukuri. / Nga Libri “Mythology – Timeless tales of Gods and Heroes” – Në shqip nga Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enverti
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Prishtina mposhti Ponte Prizrenin, Ylli iu rikthehet fitoreve

PRISHTINË, 5 SHKURT - Sigal Prishtina ka shënuar fitore ndaj Ponte Prizrenit me rezultat 72:52 (15:12, 18:12, 15:12, 24:16), në xhiron e 21-të të Prince Caffè Superligës. Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë, me prizrenasit që kishin epërsi prej katër pikësh, 8:12, por një seri prej 7:0 e kryeqytetasve bëri që të fitojnë këtë pjesë 15:12. Prishtinasit në periudhën e dytë disa herë ishin në epërsi prej nëntë pikësh, aq sa edhe përfundoi pjesa e parë 33:24, kurse epërsinë më të lartë e kishin pranë rezultatit 33:22. Perioda e tretë ishte e ngjashme më të parën, madje, përfundoi në mënyrë identike 15:12, ndërsa mysafirët në tre çerekët e parë të ndeshjes shënuan

nga 12 pikë, ku rezultati pas 30 minutash ishte 48:36. Bardhekaltrit ruajtën epërsinë deri në fund dhe nuk e rrezikuan fitoren, duke triumfuar me 20 pikë dallim, 72:52. Te vendasit u dalluan Brooks Debisschop me 16 pikë e 15 kërcime dhe Dustin Thomas me 16 pikë e 16 kërcime, kurse Cameron Williams ishte i vetmi me pikë dyshifrore te mysafirët me 14 sosh. Sigal Prishtina ka 16 fitore e pesë humbje, kurse Ponte Prizreni numëron shtatë fitore e 14 humbje. Golden Eagle Ylli është rikthyer te fitoret, duke mundur Bashkimin me rezultat 75:58 (16:12, 30:15, 11:11, 18:20), në xhiron e 21-të të Prince Caffè Superligës. Therandasit e nisën

për mrekulli ndeshjen me një seri të suksesshme 12:2, megjithatë prizrenasit filluan rikthimin dhe çereku i parë përfundon 16:12. Në periudhën e dytë u bë dallimi i madh dhe vendimtar në këtë sfidë. Në këtë pjesë kampionët e Kosovës ishin bindshëm më të mirë (30:15), për të shkuar në pushim me rezultat 46:27. Perioda e tretë ishte e barabartë, dhe u karakterizua me shumë pak pikë të shënuara, gjithsej 22, nga 11 për të dy skuadrat, ndërsa shifrat pas 30 minutash ishin 57:38. Në dhjetë minutat e fundit prizrenasit tentuan të bëjnë rikthimin e madh, por vetëm afruan rezultatin në 11 pikë, ndërsa Ylli triumfoi 75:58. Te



therandasit u dallua Gëzim Morina me 23 pikë e shtatë kërcime, ndërsa te prizrenasit u dallua Sandro Samuels me 18 pikë

e 12 kërcime. Golden Eagle Ylli ka 16 fitore e pesë humbje, ndërsa Bashkimi numëron nëntë fitore e 12 humbje.

Gjilani, Malisheva e Behari kalojnë në çerekfinale



GJILAN, 5 SHKURT - Janë mësuar edhe tri skuadra tjera çerekfinaliste të Kupës së Kosovës, teksa skuadra e fundit që do ta sigurojë biletën për këtë fazë të garave do të përcaktohet të hënën. Në fakt, ndeshja ndërmjet Prishtinës dhe Dukagjinit, e paraparë të zhvillohej sot në Lipjan, u shty për 24 orë nga Komisioni i Garave, për shkak të kushteve atmosferike dhe ngricave të

shumta në fushën e stadiumit "Sami Kelmendi". Ndërkohë, Gjilani ka arritur fitore bindëse në duel me Vjosën, me rezultat 4:0. Të katër golat skuadra e Zekirija Ramadanit i shënoi në pjesën e dytë. Shifrat i zhbllkoi Theophilus Solomon, në minutën e 49-të, derisa më pas realizuan edhe Mevlan Zeka (53'), Baton Zabërgja (81') dhe Albert Dabiçaj (85'). Fitore para tifozëve të vet ka realizuar edhe

Malisheva, e cila e mundi skuadrën e Ligës së Parë, Fushë Kosovën, me rezultat 2:0. Golat për skuadrën e Malishevës i shënuan Bleart Tolaj (52') dhe Ronald Sobowale (84'). E pjesë e fazës çerekfinale do të jetë edhe Behari, skuadër kjo e Ligës së Dytë, e cila para tifozëve të vet e mundi skuadrën tjetër të kësaj kategorie, Prizrenin, me rezultat 3:1.

Vushtrria fiton ndaj Vëllaznimit, Besa pa telashe në Podujevë

VUSHTRRI, 5 SHKURT - Të dielën u luajtën edhe dy ndeshje të xhiros së 15-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Vushtrria ka mposhtur Vëllaznimitin e Gjakovës. Ndeshja në Vushtrri përfundoi 30:24 për skuadrën vendase. Vushtrriasit nisën menjëherë shkëputjen në rezultat, ndërsa epërsia shkoi deri në dhjetë gola. Muhamet Hyseni ishte më efikas te Vushtrria me 7 gola. 6 i kishte Bozhidar Nikoqeviq, kurse 5 i realizoi Armend Karaça. Arbër Neziri shënoi 6 gola për Vëllaznimitin, derisa 5 i kishte Granit Fana. Nga 4 i shënuan Florian Rexha e



Labinot Kërleshi. Në ndeshjen tjetër të së dielës, kampionia dhe liderja, Besa Famgas, fitoi bindshëm ndaj Llapit. Ndeshja në Podujevë përfundoi 46:20 në të mirë të ekipit pejan. Olsi Mulaj

ishte më efikas me 11 gola. 8 i realizoi Arbios Mushkolaj, kurse 7 i shënoi Franco Daniel Gavidia. Te Llapi u shqua Blerton Hasani me 8 gola. Endrit Havolli shënoi 5 gola.

Derbi i takon Interit

MILANO, 5 SHKURT - Nuk kishte si të shkonte ndryshe, Interi mund një Milan "të dobët" në "Derbin e Madoninës", teksa ka arritur të fitojë me rezultatin minimal 1 me 0, falë golit të Lautaro "El toro" Martinez. "Zikaltrit" u hodhën menjëherë në sulm, por Tatarusanu ishte i vëmendshëm duke mos lejuar topin të prejë rrjetën e "djajve". Mirëpo në minutën e 30'-të të lojës, një krosim i Calhanoglu nga goditja e këndit gjen të pambuluar në zonën kapitenin Lautaro Martinez, i cili me një goditje të bukur me kokë dërgon topin në rrjetë. Ky do të ishte dhe goli i vetëm i



ndeshjes, me "zikaltrit" që arritën fitoren e dytë radhazi ndaj Milanit, pas fitores 3 me 0 në Superkupën e Italisë. Me këtë fitore Inter arrin në kuotën e 43 pikëve dhe ndodhet në vendin e dytë, ndërsa Milani aktualisht ndodhet në vendin e 6-të me vetëm 38 pikë

Barcelona shkatërron Sevillan

BARCELONË, 5 SHKURT - Barcelona vijon e qetë rrugëtimin drejt titullit kampion në La Liga, teksa sot ka marrë fitoren e pesë radhazi që e largon +8 pikë

nga Real Madridi. Skuadra katalanase shkatërroi 3-0 Sevillan në duelin e vlefshëm për javën e 20-të. Pas një pjese të parë pa gola, në fillimin e së dytës, Jordi Alba

do të kalonte në avantazh ekipin katalanas pas një asisti nga Kessie. Më tej do të ishte gjithçka e thjeshtë për Barcelonën që do të shënonte dy gola të tjerë me

Gavin dhe Raphinha. Barcelona tashmë është ngjitur në kupton e 53 pikësh pas 20 javësh, teksa numëron 17 fitore, dy barazime dhe vetëm një humbje.





Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C.
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551, 500 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH. A.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Neni 21, neni 21.4, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative pika 15.3 për Ndërmarrjet Publike. Bazuar në Vendimin Nr.09/2022 të Bordit të Drejtorëve të KMDK-së, me numër të protokollit 01-59/9, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS)

Titulli: Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit –ZKFTH

Numri i Referencës: ZP/KJ-3-2023.

I raporton: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv

Niveli i pagës: Niveli II.

Orët e Punës: 40 orë në javë.

Mandati: 3 vite me mundësi vazhdimi.

Vendi i punës: Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari Kryesor i Financave dhe Thesarit të Kompanisë (ZKFTH) do të menaxhojë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE-se si dhe punët shtesë sipas nevojës të kërkuara nga KE-ja, çështje financiare të Kompanisë, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Bordi i Drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për Kompaninë dhe do të jetë përgjegjës që:

-Të mirëmbajë llogaritë e kompanisë të azhurnuara dhe të sakta.

-Të themelojë dhe të udhëheqë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore.

-Zyrtari Kryesor Financiar në nivelin kryesor të subjektit publik, është në vartësi të drejtpërdrejtë dhe llogaridhënës ndaj Zyrtarit kryesor administrativ për operacionet financiare, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit publik.

-Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve financiare të subjektit të sektorit publik për garantimin e cilësisë dhe pajtueshmërisë së:

✓ Dokumentit final të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të planifikimit të subjektit publik;

✓ Raporteve periodike për monitorimin e buxhetit për vendimmarrësit;

✓ Transaksioneve financiare, kontabilitetit dhe pasqyrave vjetore financiare të subjektit publik në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe aktet nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave;

✓ Rregulloret e brendshme të menaxhimit financiar, hartimit të proceseve dhe fushat me rrezik, duke siguruar gjurmët e auditimit për të gjitha proceset në kuadër të subjektit dhe listat për kontrollë financiare për të gjithë personelin e financave të subjektit publik.

-Zyrtari Kryesor Financiar ngarkohet me zbatimin e përgjegjësisive sipas nenit 8 të këtij Ligjit Nr.

06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike.

-Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale.

-Të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e

korporatës dhe buxhetin para pagesës së tyre.

-Të përgatisë të dhënat e kompanisë për auditim në fund të vitit.

-Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve të KMDK SH.A.

-Të menaxhojë thesarin e kompanisë.

-Të vendosë dhe përgatisë buxhetin.

-Kryen detyra të tjera shtesë sipas ligjeve në fuqi që ndërlidhen me pozitën e caktuar.

-Detyra tjera të përcaktuara nga ana e KE dhe udhëzimet nga BD.

-Për punën e tij i përgjigjet BD dhe KE.

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

-Diplomë e Fakultetit Ekonomik.

-Përvojë pune së paku 5 vjeçare e dëshmuar në menaxhimin e financave

Aftësitë kryesore:

-Demonstrim i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin

dhe stafin e kompanisë;

-Të ketë njohuri në programin e kontabilitetit “Quick Books”.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara e punës:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pika d, f, j, k, l dhe (iii) kanë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, me kusht që (i) Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit.

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit.
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në menaxhim të financave dhe/ose kontabilitetit.
- Preferohet të jetë kontabilist i çertifikuar nga ndonjë autoritet financiar i licencuar nga KKRF-ja apo ndërkombëtar.
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të të cilave raporton Ndërmarrja.
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional.
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim financiar.
- Të njohë standardet e kontabilitetit dhe raportimeve financiare.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime.

Procedura e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrën e KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrat e KMDK SH.A në adresën: Rruga “Bekim Fehmiu” Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës “Shtjefën Gjeçovi”), “Lakrishtë”. Tel: 038/ 600 – 552.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni.
- CV e detajuar (formati Europass).
- Kopja e letërnjoftimit ose Pasaportës me afat.
- Letër e Motivimit.
- Kopje e Diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për Diplomat e marra jashtë vendit.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga Institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, qe e përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë.
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë Institucion).
- Deklarata nën Betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP-së e cila mund të shkarkohet nga ueb faqja e Kompanisë;
- Çertifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është tridhjetë (30) ditë kalendrike nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 06.02.2023 deri me datën 07.03.2023 ora 08:00-16:00h.

Vërejtje: Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

Për informata më të hollësishe mund të kontaktoni në Zyrën e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A Email: info@kmdk-ks.org Tel: 038/ 600 552.



KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU dd.

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima Član 21, na osnovu člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, na osnovu Etičkog kodeksa i tačke korporativnog upravljanja 15.3 za javna preduzeća, na osnovu Uredbe br. 23/2020 o postupku zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK dd i na osnovu Odluke br. 09/2022 Upravnog odbora KMDK, sa protokolom broj 01-59 /9, Kompanija za upravljanje deponijama u Republici Kosovo saopštava sledeće:

JAVNI KONKURS (ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA)

Zvanje: Glavni službenik za finansije i trezor - ZKFTH

Referentni broj: ZP/KJ-3-2023

Izveštava: Upravnom odboru i glavnom izvršnom direktoru

Nivo plata: Nivo II

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Mandat: 3 godine sa mogućnošću produženja.

Mesto rada: KMDK SHA, Centralna kancelarija Priština

Dužnosti i odgovornosti:

-Glavni službenik za finansije i trezor Kompanije (ZKFTH) upravljat će pod vodstvom i nadzorom EK, kao i dodatnim radom prema zahtjevima EK, finansijskim pitanjima Kompanije, u zavisnosti od ograničenja postavljenih od strane Upravnog odbora, ima ovlaštenje da zaključuje sve finansijske ugovore za Kompaniju i biće odgovoran za:

-Održavati ažurne i tačne račune kompanije;

-Uspostavljanje i upravljanje svim internim finansijskim kontrolama, uključujući nabavke, gotovinske primitke i osnovna sredstva;

-Glavni finansijski službenik na glavnom nivou javnog subjekta je direktno podređen i odgovoran glavnom administrativnom službeniku za finansijsko poslovanje, računovodstvo i sastavljanje finansijskih izvještaja javnog subjekta.

- Glavni finansijski službenik je odgovoran za nadzor svih finansijskih aktivnosti subjekta javnog sektora kako bi osigurao kvalitet i usklađenost:

- ✓ Završni budžetski dokument i koordinacija rada tokom procesa planiranja javnog subjekta;
- ✓ Periodične izvještaje za praćenje budžeta za donosioce odluka;
- ✓ Finansijske transakcije, računovodstveni i godišnji finansijski izvještaji javnog subjekta u skladu sa zahtjevima važećeg zakonodavstva i podzakonskih akata koje donosi ministar finansija;
- ✓ Interni propisi upravljanja finansijama, dizajn procesa i područja rizika, obezbjeđivanje revizorskih tragova za sve procese unutar subjekta i liste finansijskih kontrola za svo finansijsko osoblje javnog subjekta.

-Glavni finansijski službenik je zadužen za sprovođenje odgovornosti iz člana 8. ovog zakona br. 06/L-021 za unutrašnju kontrolu javnih finansija.

-Pratite obaveze i koordinirati plaćanje faktura i posebnih nabavki.

-Preispituje troškove zaposlenih kako bi osigurao usklađenost sa korporativnim politikama i budžetom prije plaćanja

-Pripremiti podatke kompanije za reviziju na kraju godine

-Da koordinira druge poslovne funkcije, kao što je davanje u zakup objekata i opreme KMDK SH.A.

-Da upravlja trezorom društva;

-Odrediti i pripremiti budžet;

-Obavlja i druge dodatne poslove u skladu sa važećim zakonima koji se odnose na raspoređeno radno mjesto.

-Druge poslove koje utvrđuje EK i uputstva BD;

-Za svoj rad odgovara BD i EK.

Kvalifikacije i radno iskustvo:

-Diploma Ekonomskog fakulteta;

-Najmanje 5 godine dokazanog radnog iskustva u finansijskom menadžmentu;

Ključne vještine:

-Pokazivanje odličnih komunikacijskih i kooperativnih vještina sa menadžmentom i osobljem kompanije;

-Poznavanje računovodstvenog programa "Quick Books".

Zahtevani uslovi i kvalifikacije: Upravni odbor želi da obezbedi da svi potencijalni kandidati budu osobe poznatog integriteta koje ispunjavaju uslove kvalifikacije prema članu 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačka d, f, j, k, l i (iii) imaju potrebno profesionalno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju, pod uslovom da (i) glavni službenik za finansije i trezor ima univerzitetsku diplomu i značajno profesionalno iskustvo u oblasti finansija i/ili računovodstva.

Pored opštih uslova, kandidati moraju ispunjavati i sledeće posebne uslove:

- Da imaju visoku stručnu spremu i značajno profesionalno iskustvo u oblasti finansija i/ili računovodstva

- Najmanje 5 godina radnog iskustva u oblasti finansija i/ili računovodstva

- Poželjno je da bude računovođa sa sertifikatom bilo kog finansijskog autoriteta licenciranog od strane KKRF-a ili međunarodnog,

- Da ima znanje o tumačenju Međunarodnih računovodstvenih standarda (MRS) i Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI) na osnovu kojih kompanija izveštava,

- Da ima visok moral i profesionalni integritet,

- Da poseduje dokazane veštine finansijskog upravljanja,

- Poznavanje standarda računovodstva i finansijskog izveštavanja,

- Poznavanje stranih jezika je prednost,

- Ne osuđivan ili pod istrago

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični obrazac u kancelariji KMDK SHA ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji u kancelarijama KMDK SA na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole "Shtjefën Gjeçovi"), "Lakërisë". Telefon: 038/ 600 – 552.

Potrebna dokumentacija za prijavu:

- Aplikacija,

- Detaljan CV (Europass format),

- Kopija lične karte ili pasoša sa rokom,

- Motivaciono pismo,

- Kopija diploma o školskoj spremi, nostrifikacija za diplome stečene u inostranstvu;

- Dokaz o radnom iskustvu/uvjerenje o radnom stažu izdato od nadležnog zavoda za zapošljavanje, kojim se utvrđuje radno mjesto kao i trajanje angažovanja na toj poziciji;

- Izjave o penzijskim doprinosima (ne zahtevaju se za radno iskustvo pre osnivanja Kosovskog penzijskog štednog fonda i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili obavezni da plate ovoj instituciji);

- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa sajta Kompanije;

- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja);

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.


Rok za prijavu je trideset (30) kalendarskih dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/elektronskim platformama i web stranicama KMDK, počev od: 02.06.2023. do 03.07.2023. godine u 8:00 – 16:00 časova.

Napomene: Kandidati sa nekompletnom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van konkursnog roka biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju definisane kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A


Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 552.




Titulli i Org. / Nazivna Organizacija	1.04	No. i prot. / Broj N. / Ser. Prot.	01/172/23
No. Faqes / No. Stranica	4/	Data / Datum	03.02.2023

PRISHTINE - A



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA
GOVERNMENT OF KOSOVA

Prishtinë, 06. 02. 2023

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Neni 25 paragrafi 1, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Neni 23 paragrafi 1, dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 01.02.2023 mori vendimin për të shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës: Drejtor

Institucioni: Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë

I përgjigjet: Këshillit Drejtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri"

Vendi: Prishtinë

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

- Të jetë doktor i shkencave të historisë, përkatësisht t'i plotësojë kushtet për t'u zgjedhur së paku në titullin bashkëpunëtor i lartë shkencor.
- Të ketë përvojë dhe aftësi të dëshmuara në organizimin dhe udhëheqjen e punëve kërkimore-shkencore.
- Kandidati, me rastin e konkurrimit duhet të paraqesë projektin për zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, si dhe të organizimit të punëve të tjera në Institut.

Detyrat dhe përgjegjësitë: Drejtori i Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, ka detyrimet dhe përgjegjësitë e ngarkuara me ligj, me Statut të Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë:

- Udhëheq dhe e përfaqëson Institutin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së Institutit;
- Udhëheq dhe organizon veprimtarinë e Institutit dhe ndërmerr masa për realizimin e saj;
- Kryeson Këshillin Drejtues, si dhe përkujdeset për zbatimin e vendimeve të tyre;
- Kryeson Këshillin Shkencor;
- Është urdhëruar dhe përgjegjës për zbatimin e planit financiar të Institutit;
- Organizon punën dhe veprimtarinë e Institutit;
- Nxjerr aktin për sistematizimin e vendeve të punës sipas propozimit të Këshillit Shkencor;
- Nënskruan kontratat e punës me punëtorët e Institutit;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e Institutit.

Kohëzgjatja e zgjedhjes: Mandati i drejtorit është katër vjet.

Kandidatët duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën
- Biografinë (CV)
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Përmbledhjen e përvojës menaxheriale, dhe përvojës kërkimore-shkencore;
- Vërtetim të lëshuar nga organi kompetent që vërteton se ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar hetim;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Zgjedhja e drejtorit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.


Dokumentet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, kurse dokumentet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët, dokumenteve të tyre duhet ti bashkëngjisin kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon pozita për të cilën konkurrojnë.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Institutin e Historisë në Prishtinë (në objektin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës) kati i dytë, zyra e Bibliotekës, adresa: Rr. „Arbnor e Astrit Dehari“ nr. 25 | 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.


Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/ 512-303, prej orës 08:00 - 16:00 (apo në ueb-faqen <https://ih-rks.org/>).




Titulli i Org. / Nazivna Organizacija	1.04	No. i prot. / Broj N. / Ser. Prot.	01/172/23
No. Faqes / No. Stranica	4/	Data / Datum	03.02.2023

PRISHTINE - A



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 06. 02. 2023

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o Naučno Istraživačkoj Delatnosti - (Službeni List Republike Kosova, br. 11/02 Maja 2013), člana 25 tačka 1; Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, člana 23 tačka 1, Administrativno Uputstvo (MRSZ) BR.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru, Upravni savet na sednici održanoj 01.02.2023 doneo odluku da raspisuje:

KONKURS

Zvanje: Direktora

Institucija: Istorijski Institut "Ali Hadri" - Priština

Odgovara: Upravnom Savetu Istoriskog Instituta "Ali Hadri" – Priština

Mesto: Priština

Kandidati moraju da ispunjavaju sledeće uslove:

- Da je doktor istorijskih nauka, odnosno da ispunjava uslove za izbor u zvanje visoka naučnog saradnika.
- Da ima dokazano iskustvo i veštine u organizaciji i rukovođenju naučno-istraživačke delatnosti.
- Kandidati će, povodom konkursa, predstaviti projekat za razvoj naučno-istraživačke radova, kao i organizaciju drugih radova u Institutu.

Dužnosti i odgovornosti: Direktor Instituta za istoriju "Ali Hadri" - Priština, ima obaveze i odgovornosti određene zakonom, a Statutom Instituta za istoriju "Ali Hadri" - Priština:

- Rukovodi i predstavlja Institut i odgovoran je o zakonitosti delovanja instituta;
- Rukovodi i organizuje rad i delovanje institute i preuzima mere za njegovu realizaciju;
- Upravlja Upravnog odborom, i stara se o sprovođenju njihovih odluka;
- Upravlja naučnim savetom;
- Komanduje i odgovoran je za sprovođenje finansijskog plana Instituta;
- Organizuje rad i delatnost Instituta;
- Donosi akt za sistematizaciju radnih mesta prema predlogu naučnog saveta;
- Potpisuje radne ugovoresaradnicima Instituta;
- Vrši i druge radnje utvrđene zakonom i Statutom instituta.

Trajanje izbora: Direktor se bira na period od četiri (4) godine.

Kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zahtev
- Biografija (CV)
- Izvod iz registra rođenih ne stariji od šest meseci;
- Rezime menadžerskog iskustva i istraživačko-naučnog iskustva;
- Uverenje izdata od strane nadležnog organa kojim se dokazuje da se protiv kandidata ne vodi se istraga.

Opšti podaci za kandidate:

Direktor Instituta Istorija "Ali Hadri" bira se u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L - 135 za naučno istraživačkoj delatnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri" i Administrativno Uputstvo (MRSZ) br.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru.

Prijave poslate poštom, na kojima se nalazi poštanski žig na dostavi izvršenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i razmatraće se ukoliko stignu u roku od 4 dana, dok prijave koje stignu nakon ovog roka i one nepotpune neće biti uopšte razmatrane

Kandidati su dužni da uz svoja dokumenta prilože kopije dokumentacije o stručnoj spremi, iskustvu i drugu neophodnu dokumentaciju koju zahteva radno mesto za koje konkuriraju.

Popunjena dokumenta predaju se Institutu za istoriju u Prištini (u objektu Državne Arhivske Agencije Kosova), drugi sprat, kancelarija biblioteke, adresa: Ul. „Arbnor e Astrit Dehari“ br. 25 | 10000 Priština, Republika Kosova.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj. tel: 038/ 512 - 303, od 08:00 - 16:00 (ili na sajtu <https://ih-rks.org/>).



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues